



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0942

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “INFINITT” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “169 Paisje, rekuizita sportive” me numër të prokurimit 616-25-5614-1-2-1, me 12/11/2025, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si pjeserisht e bazuar ankesa e OE “INFINITT” SH.P.K. me nr. 2025/0942, e datës 22/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “169 Paisje, rekuizita sportive” me numër të prokurimit 616-25-5614-1-2-1.
- 2. Vertetohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KOMUNA PRISHTINË”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “169 Paisje, rekuizita sportive” me numër të prokurimit 616-25-5614-1-2-1
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjeserisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 23.06.2025, “KOMUNA PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftim për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “169 Paisje, rekuizita sportive”

me nr. të prokurimit: 616-25-5614-1-2-1. Ndërsa me datën 03.09.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie. OE "EUROPRINT group" SH.P.K.”

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 43,000.00 €.

Me 08.09.2025, OE “INFINITT” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. E cila me vendimin e AK me datën 11.09.2025 është refuzuar si te pa bazuar Kërkesën për Rishqyrtim.

Me 22/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “INFINITT” SH.P.K me nr. 2025/0942 për lidhur me aktivitetin “169 Paisje, rekuizita sportive” me nr. të prokurimit: 616-25-5614-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “INFINITT” SH.P. K janë parashtruar si në vijim:

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit dhe ri-vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik. AK/zyra e prokurimit me 18.08. ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar për kontrate Grupin e OE Arbnora Zabeli Aliu &EUROPRINT GROUP SH.P.K.

Me 20.08. kemi dërguar kërkesë për qasje ne dokumente zyrtare dhe te njëjtën dite me 20.08. AK na ka lejuar qasjen ne dokumente zyrtare sipas kërkesës tone.

Nga dokumentet te cilat kemi pranuar ne qasjen ne dokumente zyrtare konstatojmë se AK/komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontrate grupin e OE te papërgjegjshëm te cilët nuk plotësojnë kapacitetin teknik profesional sipas kërkesave ne nenin 9.1&9.2 te FDT-se, citoj kërkesën ne dosjen e tenderit:

Kapaciteti teknik dhe professional Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës se njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) jo me pak se 50.000.00€

6. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.

Grupi i OE ka dorëzuar ANEKS 6 Listën e kontratave të realizuara por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentare Referencat apo certifikatat për kryerjen e furnizimeve në vlerë jo më pak se 50,000.00.

Referencat valide të cilat ka dorëzuar OE janë si në vijim:

KK Prishtinë në vlerë 14,947.00

Shërbimi Korrektues 10,785.00

Shërbimi korrektues 4846.00

KK Elez Han 9253.00

Totali i këtyre dëshmive/referencave arrin vlerën 39831.00euro

Në këtë mënyrë grupi i OE rezulton se janë të përgjegjshëm pasi që nuk kanë dorëzuar dëshmi të mjaftueshme se kanë realizuar kontrata të ngjashme në vlerë minimale 50,000.00euro.

AK pas kthimit të lëndës në ri-vlerësim në bazë të shkresave të lëndës shihet se ka kërkuar sqarime shtese nga OE i rekomanduar për kontratë mirëpo përsëri OE rezulton i përgjegjshëm pasi që sqarimet shtese të cilat ka dërguar janë të pavlefshme.

OE ka bashkangjitur edhe njëherë dëshmitë për realizimin e 4 kontratave të lartcekura të cilat arrijnë vlerën 39831.00euro, por dëshmitë tjera të cilat ka bashkangjitur janë jo valide për arsyeje si në vijim:

Referenca e lëshuar nga KK Vushtrri është e papranueshme sipas nenit 72.3 të LPP-se pasi që përmban datë 01.09.2025. 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Poashtu sipas nenit 59.2 të LPP-se Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues. Në këtë mënyrë AK nuk është dashur të pranojë si valide referencën e lëshuar nga KK Vushtrri me 01.09. të cilën OE e ka dorëzuar si sqarim shtese. Referenca e lëshuar nga KK Podujevë është e papranueshme sipas nenit 72.3 të LPP-se pasi që përmban datë 02.09.2025. 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Poashtu sipas nenit 59.2 të LPP-se Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues. Në këtë mënyrë AK nuk është dashur të pranojë si valide referencën e lëshuar nga KK Podujevë me 02.09. të cilën OE e ka dorëzuar si sqarim shtese.

Për kontratën nr.4 Furnizim me rekuizita sportive për KK Ranillug vlera e kontratës është 6693.00 ndërsa OE ka dorëzuar një faturë në vlerë 5593.00 dhe kartelën financiare por OE nuk ka dorëzuar reference ose certifikatë për kryerjen e furnizimeve për kontratën në fjalë, si dhe

fakti se kontrata nuk është realizuar për të gjithë artikujt si në kontratë është dëshmi se kontratë nuk është realizuar me sukses për këtë arsyeje dhe OE ka dështuar të dorëzojë referencën apo raportin e pranimit teknik për kontratën në fjalë sipas kërkesës në dosjen e tenderit dhe në piken 2. në Letrën standarde me të cilën I është drejtuar AK me 02.09. Poashtu OE ka dorëzuar të dhëna kontradiktore në fature paraqitet data 15.12.2022. ndërsa në kartelën financiare 13.12.2022 që nënkupton se kjo është përgatitur/lëshuar formalisht dhe përben rast për verifikim tek menaxheri I projektit në KK Ranillug pasi që OE ka vënë në lajthitje AK/komisionin vlerësues me të dhëna jo-reale. Grupi i OE po ashtu kanë dorëzuar oferte jo-normalisht të ulët e cila është dashur të trajtohet nga AK konform nenit 61.1 të LPP-se dhe nenit 41.3 të RRPP, citoj:

41.3 Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

1. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;
2. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;
3. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë.

Në këtë rast plotësohen të tri kushtet prandaj AK është dashur të zhvillojë procedurën inter partes me OE në fjalë duke pasur parasysh dhe çmimet jo-normalisht të ulëta të cilat ka ofruar për pozicione të caktuara, me poshtë paraqesim krahasimin mes çmimeve të ofertuar dhe çmimeve të tregut ku shihet se grupi i OE të rekomanduar për kontratë kanë ofruar çmime jo-normalisht të ulëta në disa raste deri dhjetëfish me të ulëta se çmimet e tregut:

AK për këto pozicione ka kërkuar që produktet të jenë kualitative, ekuivalente me Elan, Shaff etj. Më parasysh se inventari sportiv përdoret në shkollat e komunës së Prishtinës dhe pranimi i produkteve me kualitet të dobët mund të shpie deri të lëndimi i nxënësve apo sportistëve AK është dashur të shqyrtojë ofertën e OE dhe të ofrohen dëshmi për kalkulimin e çmimeve për këto pozicione duke dëshmuar ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit.

Në shkresat e lëndës të cilat kemi pranuar në qasjen në dokumente zyrtare nuk kemi hasur dëshmi që AK/komisioni ka trajtuar ofertën e grupit të rekomanduar për kontratë konform nenit 61.2 të LPP-se për pozicionet 13-18 OE ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta deri dhjetëfish me të ulëta se çmimet e tregut prandaj AK është dashur të zhvillojë procedurën inter-partes duke kërkuar sqarime shtese nga OE për këto pozicione.

Shkelje tjetër procedurale e ndodhur në këtë aktivitet të prokurimit është se më 16.09. ka skaduar vlefshmëria e ofertave, kompania jone ka bërë vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës megjithëse AK nuk ka kërkuar të bëhet vazhdimi i vlefshmërisë konform nenit 30.4 të Rrpp.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “INFINITT” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1- Qëllimi Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 59.2- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi I tenderëve Neni 60- Kriteret për dhënie të kontratës Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale Neni 72.3- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Neni 30.4 I Rregullores për

prokurim publik- Validiteti i Tenderit Neni 40 i Rregullores për prokurim publik- Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Neni 41 I Rregullore për prokurim publik- Tenderët Jo-normalisht të Ulët. Mare parasysh faktet e lartcekura konstatohet se AK/komisioni vlerësues ka rekomanduar për kontratë OE të përgjegjshëm në aspektin administrativ si dhe mos plotësimin e kërkesave që ndërlidhen me kapacitetin teknik&profesional prandaj kërkojmë që ankesa e kompanisë sonë të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Përgjigje në kërkesën për Rishqyrtim: Operatori ekonomik "Infinit" (tutje "parashtruesi") me datë 08.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "169 Paisje, rekuizita sportive" me nr. të prokurimit 616-25-5614-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merit (in meritum) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1. "Grupi i OE ka dorëzuar ANEKS 6 Listën e kontratave të realizuara por nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentare Referencat apo certifikatat për kryerjen e furnizimeve në vlerë jo më pak se 50,000.00".

Lidhur me këtë pretendim është gjetur se komisioni vlerësues ka kërkuar sqarime shtesë nga OE dhe përmes sqarimeve shtesë OE ka dorëzuar referencat në fjalë sipas listës së kontratave të cilën e ka bashkëngjitur në ofertë. Prandaj pretendimi është i pabazuar.

-2. - "Grupi i OE poashtu kanë dorëzuar oferte jo-normalisht të ulët e cila është dashur të trajtohet nga AK konform nenit 61.1 të LPP-se dhe nenit 41.3 të RRPP".

-Lidhur me këtë pretendim është gjetur se diferenca në mes të çmimit të ofruar nga parashtruesi dhe tenderuesi i rekomanduar është vetëm rreth 3-4 mijë euro. Ndërsa çmimi i ofruar nga tenderuesi i rekomanduar është shumë më pak sesa 30% e mesatares së ofertave të përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 30.09.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0942/2025, ndërsa me datë

10.10.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0942/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhënë përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizo i të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “INFINITT” SH.P. K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0942 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese në OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues/ Komuna e Prishtinës nuk i ka respektuar kryesisht dispozitat e nenit 59 të LPP-se duke rekomanduar për kontratë një operatore ekonomik të përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, sqaron se pas përfundimit të vlerësimit të ofertave AK-Komuna e Prishtinës, me datën 03.09.2025 e njofton OE ankues, me letrën standarde të tenderuesit të pasuksesshëm.

OE ankues, me datën 08.09.2025 ka parashtruar kërkesën për Rishqyrtim pran autoritetit kontraktues, ndërsa AK me datën 10.09.2025 ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues Infinitit shpk.

Pretendimi nr. 1 OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat, ku AK ka kërkuar:

6. Një listë të kontratave të realizuara në vlerë 50,000.00€, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e

përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve.

OE i rekomanduar për kontrate ne ofertën e tij ka dorëzuar listën e kontratave, si ne vijim:

OE ankues, pas pranimit të Vendimit (B58), ka ushtruar të drejtën e ankesës konform nenit 108/A, ku i ka kontestuar kontratat dhe referencat dhe me këtë rast AK ka kërkuar sqarime shtese nga i rekomanduari për kontrate i cili ka dorëzuar dëshmi shtese për kontratat e dorëzuara në oferte.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues i konteston referencat e lëshuara nga Komuna Vushtrisë ne vlere prej: 3,521.00 e lëshuar me date 01.09.2025, pastaj referencën e lëshuar nga Komuna e Podujevës e lëshuar me 02.09.2025, ne vlere prej: 15,279.00 dhe kontratën furnizim me rekuizita sportive për KK Ranillug vlere e kontratës është 6,693.00, ndërsa OE ka dorëzuar një fatura ne vlere 5,593.00 dhe kartelën financiare por OE nuk ka dorëzuar reference ose certifikatë.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar pretendimin e OE ankues dhe referencat e dorëzuara te OE të rekomanduar për kontrate, vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues, sepse referencat e dorëzuar nga i rekomanduari për kontrate datën e lëshimit e kanë ne muajin Shtator siç e ka përshkruar ne ankese OE ankues dhe ky fakt bie ne kundërshtim me paragrafin 3 te Nenit 72 të LPP-së. Ne vazhdim eksperti shqyrtues, vlerëson se ne rast se zbriten vlerat e cekura me larte te referencave te dorëzuara pas datës: 18.07.2025 nga totali prej: 65,000.00€, atëherë rezulton qe OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kërkesën ne vlere prej: 50,000.00€ lidhur me kontrata dhe referenca.

Pretendimi nr. 2 OE ankues, pretendon se OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar çmime Jo/Normalisht te ulëta për disa pozicione te paramases, eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky pretendim sepse sipas dispozitave të Nent 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimeve është e drejte e autoritetit kontraktues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues, kështu i fal besimin vetëm në përgjigjen lidhur me pretendimin e dytë dhe jo në përgjigjen lidhur me pretendimin e parë. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Ankuesi pretendon se GOE i rekomanduar nuk plotësojnë kapacitetin teknik profesional sipas kërkesave në nenin 9.1&9.2 të FDT-se, citoj kërkesën në dosjen e tenderit: *Kapaciteti teknik dhe profesional Dëshmia e kërkuar dokumentare:1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50.000.00€, Paneli shqyrtues lidhur me këtë pretendim ankimor në bazë të dokumentacionit të ofruar nga OE i rekomanduar gjithnjë duke pasur parasysh veprimet e komisionit vlerësues të AK konstaton se, me datë 28.08.2025 AK ka kthyer lenden në rivlerësim kështu duke kërkuar sqarimet e nevojshme tek OE i rekomanduar dhe AK pas këtyre sqarimeve me datë 02.09.2025 konstaton se janë plotësuar kërkesatë parashtruara kështu duke rekomanduar përsëri OE e njëjtë .*

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor , verën se në ofertë sipas dokumentacionit të ofruar gjenden kontratat e ofruara nga OE i rekomanduar : 1)Shuma 14,947.00 € datë kontratë 22.04.2025 2)Shuma 10,785.00 € datë kontratë 11.02.2025 3)Shuma 4,846.00 € datë kontratë 27.12.2022 4)Shuma 9,253.00 € datë kontratë 22.12.20225)Shuma 3,521.00 € datë kontratë 23.08.2022 6) Shuma 15,279.00 € datë kontratë 05.06.2023 , shuma e përgjithshme e këtyre kontratave kalon shumë në kërkuar nga ana e AK , të cilat rezultojnë në shumë të përgjithshme prej 58,631.00 € , Vlenë të theksohet se të gjitha këto kontrata jënë sipas kërkesave të vendosura në DT pra brenda afatit prej 3 viteve nga data e hapjes por në ofertë referencat e dorëzuara dhe atë disa nga datat e referencave janë pas hapjes së ofertave, Paneli Shqyrtues pretendimin ankimor e kualifikon pjesërisht të bazuar ngase nga ana e AK është vlerësuar se OE i rekomanduar mund ta arrijë qëllimin e kërkuar lidhur me këtë aktivitet. Kështu Paneli Shqyrtues në këtë rast e vlerëson edhe faktin se AK ka zbatuar edhe nenin 6 të LPP-së duke kursyer buxhetin duke rekomanduar OE me ofertë më të favorshme ekonomikisht , po ashtu PSH ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se “Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”, që në këtë rast Paneli Shqyrtues, vendos që të vërteton vendimin e AK, ngase çdo vendim ndryshe do të ishte në kundërshtim me dispozitën e lartcekur por edhe me nenin 1 të LPP nenin 6 të LPP-së dhe do të ishte në dëm të interesit publik. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues në këtë rast nisat nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit.

Rrjedhimisht paneli shqyrtues duke marrë parasysh të gjitha veprimet e palëve në procedurë të shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të hollësishme, vendos t'i jep të drejtën AK që të lenë në fuqi vendimin e saj, i cili në zbatim të dispozitave ligjore ka kthyer aktivitetin në rivlerësim pas

kërkesës për rishqyrtim dhe ka rekomanduar të njëjtin OE , prandaj PSH i fal besimin komisioneve pranë AK duke pasur parasysh se këto komisione supozohen të jenë profesionale konform nenit 59 par. 1 të LPP-së, ku thote: *“Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin të plotë të plotë individuale për veprimet e kryera të ofertës”*, atëherë në kuptim të nenit 1 të LPP-së dhe nenit 6 të LPP-së dhe me qëllim që mos të prolongoj më tepër aktivitetin e prokurimit edhe më tepër dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në ndonjë argument të bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivel qendror dhe lokal) gëzon autonomi në projektin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen bërë (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasurit të drejtë të vendosin po ashtu edhe për OE të rekomanduar për marrjen e kontratave edhe në neni 24 paragrafi 2 i LPP cituar *”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të mbajtur që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të këtyre kontratave të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj”*.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e primeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: *“Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...”* si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, nenit 6 të LPP sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: *“...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”*.

Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " INFINITT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: